



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, nenit 4 dhe 8 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 të datës 28.06.2019, duke vendosur sipas kërkesës Nr.5-453-56588 të datës 16.11.2020 së OJQ-së "PICASSO" nga Lipjani, Kryetari i Komunes, nxjerr:

VENDIM  
PËR MBËSHTETJE FINANCIARE

**Neni 1**

I ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej 490 € (katërqind e nëntëdhjetë euro) OJQ-së "PICASSO" nga Lipjani, sipas kërkesës të tyre Nr.5-453-56588 të datës 16.11.2020, për ta mbështetur financiarisht për vazhdimin e projekteve të punës artistike të shoqatës së tyre pas vështirësive që kanë pasur nga pandemia COVID -19.

**Neni 2**

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2020, pozicioni buxhetor - subvencionet e planifikuara për Drejtoratin për Kulturë, Rini dhe Sport në xhirollogarinë bankare të OJQ-së "PICASSO" në nr. 1907002070031121 në BKT Bankë.

**Neni 3**

Lidhur me mjetet e shpenzuara, OJQ-jë "PICASSO" nga Lipjani duhet të sjellë raport narrativ dhe financiar duke i bashkëngjitur faturat të cilat dorëzohen në Drejtoratin për Kulturë, Rini dhe Sport më së largu deri me 30.05.2021.

**Neni 4**

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

**Neni 5**

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet OJQ-jë "PICASSO" nga Lipjani Rr. "Adem Jashari" 20/4.

1Nr. 453-56588  
Lipjan, më 03.12.2020

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Alameti

